



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

MODULI: Etika e të Veshurit dhe Arredimit

Tiranë, 2016



PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli	ETIKA E TË VESHURIT DHE ARREDIMIT
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit të zbatojnë në jetën e përditshme aspekte të etikës së të veshurit dhe arredimit.
Kohëzgjatja e modulit	Minimumi i domosdoshëm 36 orë mësimore.
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përshkruan aspekte të etikës së të veshurit dhe arredimit.</p> <p><i>Përmbajtja:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Kuptimi dhe rëndësia e etikës së të veshurit dhe arredimit.- Rregullat bazë të etikës së të veshurit.- Rregullat bazë të etikës së arredimit.- Kufizimet etike në të veshur.- Kufizimet etike në të arredim.- Rëndësia e proporcionit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit.- Rëndësia e hapësirës në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit.- Rëndësia e volumit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit.- Rëndësia e formave dhe përmasave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit.- Rëndësia e ngjyrave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit.- Ngjyrat bazë dhe derivatet e tyre.- Ngjyrat e ftohta, të ngrohta, tonalitetet e tyre.- Ndikimi i natyrës në krijimin e ngjyrave.- Ndikimi i ngjyrave në emocionet e njeriut.- Ndikimi i stinëve dhe ngjyrave në veshje dhe arredim. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje-përgjigje me gojë.- Vëzhgim me listë kontrolli. <p><i>Kriteret e vlerësimit:</i></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e etikës së të veshurit dhe arredimit;- të evidentojë rregullat bazë të etikës së të veshurit dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme;- të evidentojë rregullat bazë të etikës së arredimit dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme;- të evidentojë kufizimet etike në të veshurin dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme;- të evidentojë kufizimet etike në të arredim dhe të japë shembuj të zbatimit të tyre në jetën e përditshme;- të shpjegojë rëndësinë e proporcionit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit;- të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të proporcioneve në të veshur dhe arredim;

- të shpjegojë rëndësinë e hapësirës në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit;
- të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të hapësirës në të veshur dhe arredim;
- të shpjegojë rëndësinë e volumit në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit;
- të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të volumit në të veshur dhe arredim;
- të shpjegojë rëndësinë e formave dhe përmasave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit;
- të evidentojë dhe prezantojë shembuj të respektimit të formave dhe përmasave në të veshur dhe arredim;
- të shpjegojë rëndësinë e ngjyrave në aspektet e etikës së veshjes dhe arredimit;
- të dallojë dhe japë shembuj mbi ngjyrat bazë dhe derivatat e tyre;
- të dallojë dhe japë shembuj mbi ngjyrat e ftohta, të ngrohta, tonalitetet e tyre;
- të shpjegojë dhe japë shembuj mbi ndikimin e natyrës në krijimin e ngjyrave;
- të shpjegojë dhe japë shembuj mbi ndikimin e ngjyrave në emocionet e njeriut;
- të shpjegojë dhe japë shembuj mbi ndikimin e ngjyrave të stinës në veshje dhe arredim.

RM 2 Nxënësi realizon ide të thjeshta për veshje bazuar në aspektet e etikës së të veshurit.

Përmbajtja:

- Rëndësia dhe funksioni i veshjeve në jetën e përditshme.
- Rëndësia dhe funksioni i veshjeve në raste të veçanta.
- Funksioni estetik dhe praktik i veshjeve dhe raportet mes tyre.
- Ndikimi dhe rëndësia e modës në etikën e veshjes dhe raportet mes tyre.
- Ngjyrat, tonaliteti i dritës dhe errësirës në veshje dhe ndikimi i tyre në imazhin e individit;
- Aksesorët e veshjeve, llojet dhe rëndësia e tyre.
- Përzgjedhja e veshjes në varësi të natyrës dhe karakterit të individit, kontekstit të përdorimit të veshjes.
- Përshtatja e veshjes me petinaturën, grimin dhe këpucët.
- Dizajnimi dhe prezantimi i veshjeve të përditshme në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj.
- Dizajnimi dhe prezantimi i veshjeve për raste të veçanta në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë dhe funksionin e veshjeve në jetën e përditshme;

- të shpjegojë rëndësinë dhe funksionin e veshjeve në raste të veçanta;
- të shpjegojë funksionin estetik dhe praktik të veshjeve dhe raportet mes tyre;
- të shpjegojë ndikimin dhe rëndësinë e modës në etikën e veshjes dhe raportet mes tyre;
- të dallojë ngjyrat, tonaliteti i dritës dhe errësirës në veshje dhe ndikimi i tyre në imazhin e individit;
- të evidentojë aksesoret e veshjeve, llojet dhe rëndësia e tyre.
- të përzgjedhë veshjet në varësi të natyrës dhe karakterit të individit, kontekstit të përdorimit të veshjes;
- të përshtatë veshjen me petinaturën, grimin dhe këpucët.
- të dizenjojë dhe prezantojë veshje të përditshme në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj;
- të dizenjojë dhe prezantojë veshjet për raste të veçanta në varësi të stinës, funksionit, imazhit, praktikitetit, modës etj.

RM 3 Nxënësi realizon skicën e thjeshtë të arredimit të një ambienti.

Përmbajtja:

- Mënyrat e arredimit të ambientit.
- Cilësitë e një arredimi harmonik.
- Elementet bazë për projektin e arredimit të një ambienti të dhënë.
- Bazat e vizatimit të skicës së ambientit sipas proporcioneve.
- Zgjedhja e mënyrës së arredimit në përputhje me faktorë të ndryshëm (numri i anëtarëve të familjes, mosha, mënyra e jetës dhe nevojat e tyre, hapësira fizike në dispozicion, burimet financiare, koha etj).
- Arredimi i dyshemesë dhe tapeteve.
- Arredimi i mureve dhe tavaneve.
- Arredimi i dritareve dhe perdeve.
- Përzgjedhja dhe vendosja e pajisjeve/mobilieve (sipas proporcionit, hapësirës, volumit, ngjyrës).
- Përzgjedhja e ndriçimit (ndikimi i ngjyrës të ndriçimit dhe anasjelltas).
- Përzgjedhja e veshjes së mobilieve dhe aksesoret.
- Organizimi, kursimi i hapësirës dhe shmangia e çorganizimit.
- Konceptimi i projekt-idesë dhe prezantimi i arredimit të një ambienti të dhënë, me dorë apo kompjuter.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë mënyrat e arredimit të ambientit;
- të identifikojë cilësitë e një arredimi harmonik;
- të evidentojë elementet bazë për projektin e arredimit të një ambienti të dhënë;
- të demonstrojë bazat e vizatimit të skicës së ambientit sipas

- proporcioneve;
- të përzgjedhë stilin e përshtatshëm të arredimit për familjen e tij;
- të realizojë një skicë të thjeshtë arredimi duke respektuar raportet e planimetrisë së dhomës;
- të përcaktojë një skemë të thjeshtë ngjyrash për arredimin e dhomës dhe skemën e ndriçimit;
- të përcaktojë paraqitjen e dyshemesë, tavanit, mureve, dritareve;
- të përzgjedhë modele të përshtatshme mobiliesh dhe pajisjesh për dhomën;
- të përzgjedhë modele të përshtatshme veshjesh për pajisjet e dhomës dhe aksesorësh;
- të zbulojë mënyra për organizimin e pajisjeve të shtëpisë me qëllim kursimin e hapësirës dhe shmangien e çorganizimit;
- të konceptojë një projekt ide arredimi të një ambienti të dhënë dhe ta prezantojë me dorë apo kompjuter.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjedise të shkollës, të përshtatura për veprimtari të etikës së veshjes dhe arredimit, ose në mjedise të tjera ku kryhen veprimtari të tilla. Rekomandohet që të kryejnë edhe vizita në ndërmarrje që kryejnë punime të tilla ose të përafërta me to.
- Minimumi i orëve të trajtimit të modulit është 36 orë. Për realizimin e modulit nxënësi është i detyruar të kryejë RM 1. Rezultatet e tjera mësimore zgjidhen sipas preferencës së nxënësit, pra nxënësi veç RM1 mund të zgjedhë minimumi një nga rezultatet e tjera mësimore.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të etikës së veshjes dhe arredimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e skicave apo veprimtarive të parapërgatitjes dhe të zbatimit të etikës së veshjes dhe arredimit, fillimisht në mënyrë të mbikëqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike në lidhje me etikën e veshjes dhe arredimit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet në arritjen e kënaqshme të të gjitha kriterëve të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të përshtatshme për realizimin e modulit.
 - Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-